

VENDIM
Nr. 563, datë 31.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 107, DATË 10.2.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE
SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 6.12, e vendimit nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.12. Nxënësve që ndjekin arsimin fillor në klasën e parë në institucionet arsimore publike u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin fillor në institucionet arsimore publike nga klasa e dytë deri në klasën e pestë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Institucionet arsimore publike, si dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të teksteve për përdorim falas dhe të reja, nga klasa e parë deri në klasën e pestë.

Blerja e teksteve të reja shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e pestë në institucionet arsimore publike, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor publik, për llogari të zyrës vendore të arsimit parauniversitar.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj shtëpive botuese dhe/ose distributorëve realizohet nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, me fondet e miratuara si ‘Transferte tek individët’, në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit.

Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi janë parashikuar në buxhetin e miratuar për vitin 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama